



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS** **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

### **Procesverbal nga mbledhja e VI-të (gjashtë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 09 dhjetor 2022**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 09:05.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, ndërsa mungoi, znj.Naile Ahmeti,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe znj.Adelinë Stublla Drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-Podujevë, nga KFOR Zita Rasztik.

#### **Rendi i ditës**

**z.Xhafer Ademi**, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, sigurisht se thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim.

*Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.*

#### **1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 07 nëntor 2022**

**z.Xhafer Ademi**, Kryesues i Komitetit, theksoi, konsideroj se procesverbalin në fjalë e keni lexuar andaj u urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim.

*Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshimi miratohet procesverbali sipas materialit përkatës.*

## **1. Informatë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për gjendjen sociale - ekonomike, banimit dhe strehimit të Komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës.**

**z.Xhafer Ademi**, Kryesues i Komitetit, theksoi, tani prezentë është drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale znj. Adelina Stublla e cila sigurisht do të na jap më shumë informata rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Vlen të ceket paraprakisht me drejtoreshën e cekur kemi diskutuar rreth një rasti të cilin mund ta quaj si rast specifik, fjala është për një qytetare të komunitetit Rom emri i së cilës është Zeneta. Po ashtu edhe shefi i ZKKK z.Liman Zeqiri është i njoftuar se problemi i saj është strehimi, kohë të gjatë nuk po mundemi t’ia sigurojmë strehimin, në fakt e kemi strehuar disa herë por sërish ajo është larguar dhe për momentin ajo gjendet në spital, pra është rast specifik dhe sigurisht jeni nëm dijeni për atë sepse ka qenë edhe pjesë e mediave në disa raste kur e patën rrahë.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, ajo grua për të cilën foli parafolësi ka bërë lëvizje nga Podujeva edhe në komuna tjera, në fakt është rast specifik dhe origjinën e ka nga Komuna e Podujevës por që ka gravituar në komuna tjera.

**znj. Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës që është informatë për vitin 2022 rreth gjendjes sociale ekonomike të Komuniteteve RAE me theks të veçantë gjendjes së banimit, për gjendjen e banimit ne vazhdimisht kemi kërkesa për ndërtimin e shtëpive, strehim apo përmirësim të kushteve të banimit nga familje e Komunitetit RAE. Familjet e tilla janë vizituar nga komisioni i DSHMS, por në mungesë të buxhetit nuk kemi pasur mundësi t’iu ndihmojmë për përmirësimin e banimit të tyre, gjithashtu në mungesë të pronës nuk kemi pasur mundësi të përfshihemi në ndërtimin e shtëpive në projekte për ndërtimin e bashkëpunimit me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”. Për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike familja e Alush Bahtirit e cila ka jetuar në baraka tek stacioni i trenit, është vendosur në Lagjen e Dëshmorëve pas lirimit të një shtëpie nga një banor që ka qenë në atë lagje.

Pastaj 2 familje të tjera nga komuniteti janë ndihmuar me tjegulla për riparimin e kulmeve gjatë vitit 2022 ku DSHMS me mjete financiare kanë ndihmuar 21 familje te komunitetit REA në vlerë 2600 € nga mjetet vetanake si dhe në bashkëpunim me donatorët janë ndihmuar 214 familje me pako ushqimore dhe higjienike, dru për ngrohje, shporet, batanije pako dhe mish, rastet e tjera janë me shumë me prioritet për banim dhe jemi në pritje të buxhetit apo ndihmës së donatoreve e që shpresojmë se me kontributin e përbashkët me ju si përfaqësues të Komuniteteve t’ju ndihmojmë, jo vetëm me ndihma dhe pako ushqimore por edhe me çështjen e banimit pasi çështja e strehimit për është jashtëzakonisht çështje jetike.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, e dëgjova me vëmendje drejtoreshën e DSHMS dhe e falënderoj shumë për të dhënat e cekura. Duke pasë parasysh se ne punojmë gjatë me këto çështje mund të them se është shumë specifike çështja e banimit dhe strehimit e që shumë bukur e përmendi Drejtoresha parafolëse që problem ka qenë kryesisht problemi i pronave e që ne si Komunë dhe si institucione komunale përfshirë edhe Zyrë Komunale për Komunitete dhe Kthim koordinojmë punën në mënyrën më të mirë të mundshme dhe jemi shembull së bashku me të gjitha Drejtoritë e Ekzekutivit të Komunës me të cilat bashkëpunimi është tejet i shkëlqyeshëm.

Tani kemi një informatë dhe normale që si çështje është problematika e legalizimit të pronave të shumë banorëve që jetojnë apo që janë qytetarë të Komunës tonë nga Komunitetet jo shumicë, problematikë e cila na ka sjellë edhe

çështjen e ndërtimit dhe strehimit përmes mundësisë së ndërtimit të shtëpive sepse donatorët apo Komuna kërkon fletën poseduese dhe nuk mund të ndihmohen ata persona që nuk e ka pronën në emrin e tyre sepse janë edhe si kritere për ndihmën e atyre që dëshirojnë të kenë strehim.

Jemi në dijeni që si Komunë nuk kemi ndonjë qendër tjetër të ndërtimit social siç është në Komunitet tjerë dhe për këtë problematikë e dimë se kërkesat janë të mëdha dhe për çdo ditë sa vinë e shtohen si shkak i rritjes së popullsisë dhe disa kritereve tjera siç është martesë, krijimi dhe rritja e familjeve kërkesa këto si mjaft të nevojshme për çështjen e banimit që është një prej çështjeve më jetike.

Sa i përket çështjes së përmendur që ishte familja e Alush Bahtirit ne e dimë se jemi marrë me këtë temë dhe ka qenë temë e jona si çështje ka qenë paksa komplekse ta quaj sepse kjo familje me 23 anëtarë e ndarë në 3 pjesë dhe nuk kanë pasë pronë të vetën për çka unë e falënderoj shumë edhe Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunën si Institucion që e ka siguruar një strehim të përkohshëm në Lagjen e Dëshmorëve dhe në atë kontekst që në të ardhmen me mundësi të gjendet ndonjë formë për të gjetur ndonjë pronë e që ndoshta është paksa problematikë që prona publike të shndërrohet në prona private, çështje për të cilën edhe më parë janë diskutuar në KPF dhe në Kuvend të Komunës edhe nga Kryetari i Komunës si Ekzekutiv i Komunës por që nuk ka pasë mundësi të arrihet një gjë e tillë, megjithatë duke i parë rrethanat ne si ZKKK kësaj familje i kemi ndihmuar me një donacion sepse ajo familje e ka një zanat -farkëtarinë, pra i kemi ndihmuar me 2900 € si stimulim përmes të cilës ndoshta në të ardhmen bashkërisht mund të gjejmë mundësi të sigurohet edhe çështja e strehimit për atë dhe gjitha familjet tjera në nevojë.

Në këtë kontekst duhet të jemi të kujdesshëm dhe ta falënderojmë edhe familjen Stublla e cila ka dhuruar një pronë, temë kjo e cila ka qenë edhe përmes mediave që të ndihmohen edhe ato familje që janë në nevojë e që në këtë rast uroj të ndihmohen edhe familjet e komunitetit jo shumicë si dhe dashtë Zoti të gjendet ndonjë formë apo mënyrë që edhe ato ta gëzojnë shtëpinë që është gëzimi më i madh i mundshëm që mundet me ndodhë .

**z.Xhafer Ademi**, Kryesues i Komitetit, theksoi, vërtetë që familja Bahtiri ka pasur nevojë me vite të tëra dhe jemi marrë shumë me këtë rast por që dashtë Zoti dhe i është bërë zgjidhja për strehim e që është diçka shumë e mirë që është bërë për atë familje sepse ka qenë si pasqyrë e qytetit. Uroj që të ndahen më shumë fonde për t'i ndihmuar familjet e komunitetit jo shumicë që janë në nevojë.

**znj.Qëndresë Hajrizi**, theksoi, kam një çështje dhe po i drejtohem Kryesuesit të këtij Komiteti se a kish pas mundësi që bashkërisht të bëjmë një zgjidhje lidhur me kërkesat e shumta të cilat po adresohen në DSHMS, çështje për të cilën unë kam biseduar edhe me drejtoreshën e DSHMS që ju si përfaqësues i tyre të caktoni një takim me Ministrin e MPL-së z.Elbert dhe me Shoqata dhe donator të ndryshëm në mënyrë që t'iu ndihmojmë njerëzve të Komuniteteve jo shumicë që sado pak t'jua lehtësojmë çështjen e strehimit. Aq sa kam informata Komuna e Fushë Kosovës është duke u ndihmuar me një Shoqatë (VOAI) e cila ndihmon familjet e Komuniteteve jo shumicë edhe sa i përket strehimit, andaj në këtë drejtim t'i ndihmojmë edhe ne familjet e Komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Komunën e Podujevës

**z.Xhafer Ademi**, Kryesues i Komitetit, duke i'u përgjigjur parafolëses, theksoi, mund ta kemi një takim me Ministrin e MPL z.Elbert Krasniqi por nuk e di se a gjendet Kosovë tani sepse sa jam në dijeni ka qenë jashtë shtetit, pra në këtë vit nuk mundemi me taku mirëpo në vitin tjetër besoj që do ta kemi një takim. Në fakt ai ka ndihmuar familjet e Komuniteteve jo shumicë dhe ju ka bërë disa zgjedhje, janë disa donatorë që ndërtojnë mirëpo më pak ka bërë në Komunën e Podujevës. Pra ajo Ministri ka ndërtuar shumë shtëpi dhe gjithsesi jam interesuar që edhe në

Komunën tonë të kemi ndonjë investim, mirëpo nuk kemi mundur të jemi përfitues të atij donacioni edhe pse ata donatorë kanë qenë të interesuar të na ndihmojnë por që nuk kemi mundur të arrijmë të jemi përfitues të atij donacioni.

Unë mund të bisedoj edhe me drejtoreshën e DSHMS dhe me Ministrin e MPL që ta kemi një takim sepse kam qenë në bashkëpunim me atë organizatë dhe që çdo kërkesë e atyre familjeve ta shqyrtojmë dhe të gjejmë mënyra për t'ju dal në ndihmë.

Është e vërtetë se Komuna jonë ka qenë humane dhe i kemi trajtuar ata që kanë ardhur dhe i'u kemi siguruar strehim dhe në këtë aspekt nuk kemi pasur problem qoftë me ndihma për nxënësit qoftë me familje në nevojë për çka e falënderoj Komunën e Podujevës në këtë aspekt dhe gjithë juve për angazhimet e juaja.

## **2. Informatë rreth rasteve të kthimit dhe ri-integrimit të personave të riatdhesuar në Komunën e Podujevës.**

**z.Liman Zeqiri**, shëf i ZKKK, theksoi, besoj që e keni edhe me shkrim informatën sepse ne si Zyrë mundohemi paraprakisht që t'i kemi informatat me shkrim. Jemi në dijeni që në ZKKK është edhe çështja e personave të riatdhesuar. Çështje e riatdhesimit është nënshkruar më 28 korrik 2010 mes Bashkësisë Ndërkombëtare dhe Republikës së Kosovës dhe që nga ajo kohë ky është një proces që kohë pas kohe ka kthim të personave nga qytetet e treta si dhe nga Evropa që nuk kanë mundur të gjejnë zgjidhje apo që nuk e kanë zgjidhë statusin e tyre në shtete të ndryshme ku kanë jetuar me vite të tëra e që ne si Komunë dhe si Institucione të kujdesemi edhe për ata persona sepse kanë qenë bashkatdhetar tanë, andaj duke marr parasysh të gjitha këto parametra ne si Zyrë, ata persona faktikisht posa të arrijnë në aeroport orientohen drejt vendbanimeve të tyre ku jetojnë apo në Komunitat e tyre, pastaj kur të vizitojnë Zyrat tona marrin të gjitha informatat dhe ne ua japim nga një vërtetim si dhe i orientojmë ata për çështjet e tyre të cilat janë të domosdoshme për t'i udhëzuar se ku të informohen, mandej ne i dërgojmë në Qendrën për Punë Sociale nga e cila vazhdojnë tek Enti i punësimit marrin informata të sakta dhe nga aty në bazë të shkollimit dhe në bazë të profesionit të tyre dërgohen në Qendrat e Aftësisimit Profesionale ku trajtohen 3 javë dhe në fund certifikohen dhe nga aty vinë tek ne dhe jemi shumë të kënaqur që kemi qenë shëbull për Komunitat tjera të Kosovës ku janë aprovuar 28 kërkesa, natyrisht me ndihmën tonë duke i'u ndihmuar në projektet e tyre dhe në bizneset që ata hapin dhe funksionojnë duke krijuar të hyra për gjenerim dhe vetëpunësim familjar.

Duke u bazuar në gjitha këto që u ceken ne i orientojmë edhe në Organizatat tjera Ndërkombëtare siç janë: IOM, UNDP, URA 2 e të tjera dhe marrin ndihma shtesë personat e riatdhesuar. Çështja e strehimit është çështje më e ndërlikuar nisur nga fakti që ata vinë dhe kërkojnë strehim ose janë ndarë nga familja ose nuk kanë shtëpi e të ngjashme, dhe me kërkesën tonë në bashkëpunim me departamentin e veçantë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme mundohemi të bashkëpunojmë dhe t'iu zgjidhim edhe këtë çështje e cila fillimisht bëhet për 6 muaj me mundësi vazhdimi edhe për 6 muaj përmes pagesave që i'u bëhet nga ne si Institucione. Pastaj probleme kemi pasë me disa persona të riatdhesuar të cilët janë lajmëruar në MPB me vonesë, 6 muaj apo ka raste edhe 1 vit pas riatdhesimit, e që për të cilët janë disa kritere shtesë dhe për këtë problem kemi bashkëpunuar dhe si Komunë kemi arritur të gjejmë zgjidhje.

Nga viti 2016 janë pranuar kërkesat në kuadër të kësaj ne si Komunë nga kjo periudhë i kemi pasur 32 persona që janë kthyer, 2 prej tyre kanë qenë të komunitetit ashkali dhe 30 shqiptar prej

tyre kanë qenë edhe 4 nxënës e që problemi me nxënës është që ne kemi edhe mësim shtesë e që Komuna ofron edhe mësim shtesë por që ata nxënës kanë probleme me gjuhën mirëpo me kohën adaptohen edhe pse ndoshta viti i parë që e kanë kaluar mund t'i humb mirëpo vitin tjetër i vazhdohet ajo pjesë dhe në bazë të kësaj ata nxënës aftësohen për vazhdimin e shkollimit.

Nga ato familje një prej tyre ka siguruar strehim të përkohshëm, 3 persona kanë filluar me trajtime mjekësore dhe medikamente për çka falënderojmë QKMF-në në Podujevë që gjithmonë është e gatshme dhe pa kurrfarë hezitimi t'ju ofrojë shërbime këtyre personave dhe medikamente falas si dhe trajtimin e tyre, pastaj ka edhe persona që kanë çrregullime të ndryshme ata janë në kujdesin e QKMF-së në bashkëpunim me ne si institucion. Mandej 1 familje ka kërkuar të hyjë në Skema Sociale për çka ne mundohemi t'ju dalim në ndihmë dhe si kriter marrim gjendjen e tyre ekonomiko sociale dhe familjare, sa fëmijë kanë, moshën e tyre dhe në bazë të këtyre kritereve ata konkurrojnë për Skemë Sociale, shumë nga këta kërkojnë që të hapin biznese dhe vinë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik për proceduar të mëtutjeshme, hapin bizneset e tyre dhe përfitojnë në këtë proces.

Shumë nga këta persona përfitojnë edhe nga UNDP dhe shuma që ofron kjo Organizatë është 3000 € dhe atë për mundësi të hapjes së biznesit të tyre duke përfshirë këtu edhe pjesën e tyre dhe mbështetjen e shtetit. Me një fjalë në Podujevë këtë pjesë e kemi menaxhuar shumë mirë, pa asnjë problem, asnjë provokim dhe asnjë kërkesë shtesë duke i falënderuar Institucionet Komunale dhe të gjithë resorët që janë në nivel komunal.

### **3. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023**

**z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit,** theksoi, pra kemi formimin e një Grupi punues për hartimin e planit të punës për vitin 2023, andaj urdhëroni mund të jepen propozimet e anëtarëve.

**z.Demokrat Hodolli,** propozoj Arbnor Fazliun

**z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK,** theksoi, ndoshta do të ishte mirë që pjesë e Grupit punues të jetë znj.Sevdije Mustafa dhe z.Selver Rama, por edhe Kryesuesi i Komitetit.

**Kryesues i Komitetit,** theksoi, atëherë nëse nuk ka të tjera propozime, kush jeni për formimin e këtij Grupi punues sipas propozimeve të dhëna.

*Pas votimit, njëzëri u konstatua se formohet Grupi punues për hartimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023, në këtë përbërje:*

*Xhafer Ademi*

*Arbnor Fazliu*

*Sevdije Mustafa*

*Selver Rama*

#### 4. Të ndryshme

**z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit**, theksoi, kemi një rast siç ju informova edhe më herët në lidhjen me Romen që është Zeneta Sadiku që është rast specifik dhe po na paraqet probleme çdo 2 vite sa i përket strehimit e që e kemi strehuar disa herë por sërish e njëjta ka ndodhur në Komunën e Podujevës. Në komunitetin tonë është e vështirë t'i sigurohet strehim pasi që komuniteti nuk ka hapësirë të mjaftueshme të banimit për vete sepse jetojnë në numër të madh të anëtarëve të familjes në shtëpitë e tyre, andaj konsideroj se ne nuk po mund t'i bëjmë zgjidhje.

**znj.Adelina Stublla**, drejtoresh e DSHMS, theksoi, rasti i Zeneta Sadikut është mediatik, ajo ka qenë si rast nga viti 2016, ka qenë në strehimoren e Gjakovës dhe në atë të Prizrenit, faktikisht ka qëndruar pak kohë para vitit 2016. Para se te vijë në Kosovë ka jetuar në Gjermani dhe në Belgjik si dhe në një pjesë të kohës edhe në Itali, kështu që momentalisht është në repartin e Gjinekologjisë aty ku edhe ka lindur një fëmijë por që dita e hënë është afati ligjor që duhet të lirohet nga spitali, mirëpo faktikisht ajo nuk ka strehim, kështu që ne si Komunë na takon t'ia sigurojmë një strehim për shkak se fundja është banore dhe qytetare e jona dhe mbi të gjitha ka shpirt, dhe në këtë aspekt ne si Komunë mund të participojmë për qera kudo që ju mendoni që të ketë vend, apo ju si përfaqësues i Komitetit për Komunitete ta adresoni këtë problem meqë jeni përfaqësues të tyre edhe ju takon t'ia bëjmë një zgjidhje.

**z.Xhafer Ademi**, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa i përket rastin në fjalë do të kërkoja nga z.Selver Rama pasi që ai është përfaqësues i komunitetit rom, që të më ndihmojë që të merremi me këtë çështje, si do që të jetë ne do ta shqyrtojmë këtë problem dhe në qoftë se mundemi t'ia sigurojmë një strehim të përmendurës, përndryshe nuk kemi zgjidhje, është rast që jemi marrë me vite dhe sa po mendojmë se e zgjidhëm këtë problem, sërish i njëjti po përsëritet.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, çështja e infrastrukturës në Komunën tonë është në nivelin më të kënaqshëm dhe këtë e kam potencuar disa herë me radhë që shumica absolute e investimeve ka përfunduar dhe tani kemi filluar të investojmë në faza tjera siç janë ndriçimi i rrugëve, ndërtimin e trotuareve e të tjera të ngjashme, megjithatë Kryeministri apo Zyra e Kryeministrit për komunitete me të cilën ne kemi bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë kanë kërkuar nga ne një projekt dhe duke u bazuar dhe hulumtuar ne si ZKKK së bashku me ju kemi paraparë që ai projekt është shumë i rëndësishëm për ju si komunitete, projekt i cili ka kaluar (është pranuar) dhe ka një vlerë rreth 39,000.00€, është në Lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr."Ali Ajeti" për aq sa kam informacione që është si projekt në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe ndërlidhet me çështjen e ujësjellësit apo ujit të pijes në atë lagje sepse në atë lagje ka qenë sistem i vjetër i ujësjellësit, lagje në të cilën faktikisht jeton edhe Kryesuesi i këtij Komiteti dhe të tjerët, andaj në bashkëpunim edhe me Kompaninë përkatëse të ujësjellësit si kompani profitabile sepse janë ndërmarrje që kanë edhe interesat e tyre, mirëpo duke pasur parasysh gjendjen komuniteteve jo shumicë, atëherë unë kam intervenuar edhe në këtë Organizatë dhe në bashkëpunim edhe me inxhinierin e tyre dhe atë të Komunës e kemi dërguar projektin në Zyrën e Kryeministrit e që e kemi fituar atë donacion i cili pritet të realizohet. Pra në dy raste jam informuar se projekti në fjalë ka kaluar, e që do të thotë se është shembull i mirë që ne të jemi përfitues nga Zyra e Kryeministrit për Komunitete për këtë çështje ngase vazhdimisht na janë bërë kërkesa nga ju si Komunitet jo shumicë se keni probleme me gjendjen e ujit.

**z.Xhafer Ademi**, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj shumë z.Liman Zeqirin për këtë projekt sepse me të vërtetë ka pasur nevojë për ujë të pijshëm në atë lagje e që disa herë e kemi paraqit kërkesën edhe në Komunën e Podujevës ngase mungon uji i pijshëm dhe se ata banorë vazhdimisht blejnë ujë të pijes ngase uji aktual nuk pihet për shkak të gypave që janë shumë të vjetër. Pra me të vërtetë është projekt i qëlluar.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, na është kërkuar nga ne që të bëjmë klasifikime se cili projekt është më me rëndësi ngase ne i kemi dërguar 3 projekte. Rrugën “Sami Rama” në lagjen “Xhafer Meta” ne si Komunë mund ta mbulojmë meqë nuk është një shumë e madhe e mjeteve financiare, si dhe projekti tjetër që ka qenë është një trotuar në fshatin Batllavë tek shkolla apo në afërsi të lagjes së Ashkalive, por megjithatë me insistimin tonë dhe të Komunës është bërë ky projekt që ka të bëjë me çështjen më jetike dhe i cili ka pas koston rreth 18,000.00€ - 19,000.00€ por që ka mbërrirë koston afër 40,000.00€, domethënë që është dyfishuar kostoja dhe normal që ne e mirëpresim si ndihmë të ofruar për qytetarët e Komunës tonë.

*Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 09:35**

**Procesverbalin e mbajti  
Osman Bajrami**

**Nr.prot.01-060/04-0101068/22  
Podujevë, 09 dhjetor 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Xhafer Ademi**